



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Numri i Dokumentit Document No.	06 - 10	702	3	viti god year
Titulli i Njësia Titre / Unit	Nr. Prot. Ref. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity	
SKIPNSHCK	6422/2023		119	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1142/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1142/2023 të datës 05.09.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.10.2023, morri këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.1142/2023 të datës 05.09.2023, të parashtruar nga ankuesi

II. Çështja bije në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në bazë të nenit 79 dhe 80 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës si dhe Rregullores (QRK) Nr.05/2022 për procedurat Konkurruese dhe Pranim për Nëpunësit Administrativ dhe mbështetës, fillimisht më datë 15.06.2023 ka njoftuar lidhur me Konkursin Publik me numër të protokollit Nr.3523/03, ndërsa më datë 30.06.2023 ka shpallur Konkursin Publik për pozitën e punës „ Vozitës” në Departamentin për Shërbime të Përgjithshme /Divizioni për Transport dhe Logjistikë.

Në bazë të listës së datës 12.07.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë edhe ankuesi është përfshirë në listën e ngushtë dhe ka fituar të drejtën e intervistimit. Ndërsa më datë 19.07.2023 pas zhvillimit të intervistës Njësia Burimeve Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë ka publikuar



listën përfundimtare për kandidatin e suksesshëm, ku ankuesi në bazë të kësaj liste është renditur i treti me pesëdhjetë e gjashtë pikë tridhjetë e tre (56.33) pikë të vlefshme.

Ankuesi i pakënaqur me listën përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën e punës „Vozitës” në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 11.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit Nr.4794/02 në Komisionin Ad-hoc për ankesa në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ndërsa më datë 25.08.2023 Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Nëpunësve Mbështetës, ka nxjerrë Vendimin me numër nr.5035/02 përmes së cilit ankesën e ankuesit e ka refuzuar si të pabazuar.

Më datë 05.09.2023 ankuesi ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5954/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se konkursi publik me numër Nr.3523/03, i datës 30.06.2023 përmban shkelje në krijimin e listës së ngushtë, komisioni vlerësues nuk ka qenë i formuar sipas kritereve të përcaktuara me ligj si dhe njoftimi përfundimtar është në kundërshtim me ligjin.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa Këshilli me datë 13.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 5954/2023 të datës 05.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Forma Individuale e Intervistës e datës 18.07.2023; Njoftimi përfundimtar i datës 19.07.2023; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e datës 19.07.2023; Vendimin me numër Nr.5035/02 i datës 25.08.2023; Përgjigje me numër nr.4988/03 e datës 23.08.2023; E-mail i datës 19.07.2023; E-mailat e datës 22.08.2023; Vendim me numër nr.AP-459/2023 i datës 03.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 11.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 13.09.2023; Ankesë e datës 11.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Komisionit Ad-hoc të MINT; E-mailat e datës 19.07.2023; Njoftim i datës 28.08.2023; E-mailat e datës 28.08.2023; Pliko me numër 5429.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1142/2023 të datës 05.09.2023 të parashtruar nga ankuesi* *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokollit 1142 të datës 14.09.2023 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, dhe në bazë të shqyrtimit të lëndës, respektivisht procedurën e rekrutimit për konkursin me numër protokollit Nr.3520/2023 të shpallur më datë 30.06.2023 nga Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për pozitën e punës „Vozitës”, një (1) pozitë në Departamentin për Shërbime të Përgjithshme /Divizioni për Transport dhe Logjistikë, ka konstatuar se Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë këtë procedurë të rekrutimit për konkursin e lartë përmendur e ka shpallur duke u bazuar në nenin 79 dhe 80 të Ligjit nr.06/144 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren nr.05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranim për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës.

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 2 është përcaktuar se; "...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike". Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se "Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës" rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në konkursin me numër protokollin Nr.3520/2023 të datës 30.06.2023 të zhvilluar nga Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kolegji i Këshillit konstatoi në rastin konkret pozita „Vozitës“, në Departamentin për Shërbime të Përgjithshme /Divizioni për Transport dhe Logjistikë, në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është kategorizuar si nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson se nëpunësi administrativo-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar, se nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj ankese të datës 05.09.2023, pasi që ankuesi nuk e ka statusin e kandidatit për punësim në shërbimin civil sepse procedura e rekrutimit për konkursin me numër protokollin Nr.3520/2023 të datës 30.06.2023, për pozitën " „Vozitës“, e shpallur nga Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nuk ka qenë e shpallur për kategoritë e të punësuarve në shërbimin civil të përcaktuar sipas nenit 33 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 1142/2023 të datës 05.09.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: **Nëpunësi**

i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë Konflikt Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i Konfliktit Administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1142/2023

Kaltrina Avdullahi-Prënaj

[Signature]
Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Arkivot të KPMSHCK-së